



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:244127

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06162051

C-IV-14-0310

Parashtruesi i kërkesës

1. **M G**, Podujevë,
2. **B Z**
3. **R B**, Podujevë
4. **A M** fshati **B**, Podujevë,
5. **F B** fshati **K**, Podujevë,
6. **I H**, Podujevë,
7. **Sh N** fshati **B**, Podujevë
8. **S K** Podujevë, dhe
9. **H I**, Podujevë, që të gjithë të përfaqësuar s avokat **B I**, Prishtinë

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH FAN “Zahir Pajaziti” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 16 shtator 2024 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. **Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ankuesit B Z hedhet poshtë si e papranueshme.**
2. **Kërkesat për rishikim të Aktvendimeve të Autoritetit të Likuidimit, të ankuesve M G R BA M F B dhe Sh N aprovohen si të bazuara gjersa kërkesat për rishikim të ankuesve I H ,S K dhe H I aprovohen si pjesërisht të bazuara.**
3. **Shfuqizohen Aktvendimet e Autoritetit të likuidimit PRN046-0487 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0302 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0501 e padatur, PRN046-0557 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0533 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0317 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0303 datë 26 dhjetor 2013 dhe PRN046-0443 datë 26 dhjetor 2013.**
4. **Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit M G në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 796.11**

Euro në emër të interesit ligjor shuma prej 79.61 Euro si dhe në emër të taksave gjyqësore shumën prej 30.00 Euro.

- 5. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit R B në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 1,855.14 Euro si dhe në emër të interesit ligjor shuma prej 185.51 Euro.**
- 6. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit A M në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 2,246.10 Euro si dhe në emër të interesit ligjor shuma prej 224.61 Euro.**
- 7. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit F B në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 1,049.07 Euro si dhe në emër të interesit ligjor shuma prej 104.90 Euro.**
- 8. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit I H në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 1,740.30 Euro si dhe në emër të interesit ligjor shuma prej 174.03 Euro gjersa pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 1,740.30 Euro refuzohet si e pabazuar.**
- 9. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit Sh N në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 2,164.32 Euro si dhe në emër të interesit ligjor shuma prej 216.43 Euro.**
- 10. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit S K, në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 2,388.84 Euro si dhe në emër të interesit ligjor shuma prej 238.88 Euro gjersa pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 398.14 Euro refuzohet si e pabazuar.**
- 11. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit H I në emër të kompensimit për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, ti paguhet shuma prej 2,816.58 Euro si dhe në emër të interesit ligjor shuma prej 281.65 Euro gjersa pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 469.43 Euro refuzohet si e pabazuar.**
- 12. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që përfaqësuesit të ankuesve, avokat B I, në emër të përpilimit të kërkesës për rishikim – ankesës dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP të ja paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,248.00 Euro gjersa pjesa tjetër e mbetur prej 624.00 Euro në emër të kërkesës kreditore dhe shqyrtimit të shkresave refuzohet.**
- 13. Nuk caktohen shpenzime tjera.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 17 janar 2014, përfaqësuesi i ankuesve pranë DHPGJS, parashtror një kërkesë grupore, të emërtuar ankesë, për rishikimin e Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (Vendimi i AL) për ankuesit 1 gjer 9, me të cilat Vendime i janë refuzuar kërkesat për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të punës, në shumë të pacaktuar për të gjithë ankuesit, ndaj NSH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim).

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur Vendimet e Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN046-0487 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0302 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0501 e padaturar, PRN046-0557 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0533 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0317 datë 26 dhjetor 2013, PRN046-0303 datë 26 dhjetor 2013 dhe PRN046-0443 datë 26 dhjetor 2013.

Kërkesës për rishikim nuk i është bashkangjitur kërkesa për rishikim për ankuesin B Z.

Përfaqësuesi i ankuesve pohoi se me anë të njoftimit të Agjencisë, datë 24 mars 2006, se të gjithë ankuesve ju është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe po me të njëjtin njoftim janë informuar mbi të drejtën mbi realizimin e së drejtës në paga të papaguara, kërkesa këto të refuzuara nga ana e AL.

Përfaqësuesi i ankuesve pohon të drejtën e ankuesve, në paga, duke ju referuar dispozitave ligjore si, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48 si dhe Ligjin e punës nr. 03/L-212.

Përfaqësuesi i ankuesve fillimisht kundërshtoj Vendimet e AL, duke ju referuar parashkrimit pasi që konsideron se dispozitat e Ligjit për punën e bashkuar janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndërmarrjet (gazeta zyrtare e RSFJ nr. 77/88), tutje se Ligji themelor për punën në Kosovë – Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 nuk përmban dispozitë mbi parashkrimin dhe se ankuesit i janë përmbajtur udhëzimeve të AL mbi parashtrimin e kërkesave mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP, neni 7.4.

Përfaqësuesi i ankuesve përfundimisht kërkesën e ankuesve e konsideron të bazuar dhe atë duke u bazuar sipas Rregulloreve e UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48, si dhe dispozitave ligjore të Shtojcës Ligjit për AKP (nenin 6, 40 paragrafi 1.6 dhe neni 37).

Nga të gjitha arsyet propozon që kërkesat e ankuesve të aprovohen, duke përfshirë kamatën ligjore, për të gjithë ankuesit në lartësi prej 10%.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Një kopje të listës së pagave, të llogaritura për secilin ankues, e panëshkruar dhe vulosur,
- Kopjet e Autorizimeve për të gjithë ankuesit,
- Kopjet e Vendimeve të AL, për ankuesit 1,3,4,5,6,7,8 dhe 9,
- Kopjet e Njoftimeve mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, datë 24 mars 2006, për të gjithë ankuesit, lëshuar nga Agjencia (në tekstin në vijim NJOFTIMET),
- Kopja e Librezës së punës për ankuesin 2, B Z,
- Një kopje të palexueshme, të pagave për ankuesin 2, B,
- Kopja e Librezës së punës për ankuesin 4, A M
- Kopja e Librezës së punës për ankuesin 6, I H,
- Kopja e Librezës së punës për ankuesin 7, Sh N,
- Një kopje të palexueshme, të pagave për ankuesin 7, Sh N dhe
- Kopja e Librezës së punës për ankuesin 9, H I.

Me 3 qershor 2020, përfaqësuesi i ankuesve parashtrij parashtrësia për rregullimin dhe plotësimin e kërkesës për rishikim, për ankuesit 1. M G 3 R B 4. A M 5 F B6. I H7. Sh N 8 S K dhe 9. H I.

Me anë të këtyre parashtrësive, mbi precizimin, përfaqësuesi i ankuesve i referohet të drejtave në kompensimin e pagave të gjithë ankuesve, përvojat e tyre të punës për secilin ankues sipas

listave të publikuara mbi të drejtat në 20% nga privatizimi i NSH si dhe të drejtat në kamatat ligjore.

Tutje me anë të këtyre parashtresave përfaqësuesi i ankuesve, kundërshtoj Vendimet e AL lidhur me parashkrimin duke pohuar se Ligji për ndërmarrjet (gazeta zyrtare e RSFJ 77/88) ka shfuqizuar Ligjin për punën e bashkuar i cili është aplikuar nga ana e AL. Për ilustrim ankuesi i referohet Vendimeve të DHPGJS. Përfaqësuesi i ankuesve në vijim i referohet të drejtave të tyre për kompensim, sipas Ligjeve si ato Ligjin mbi ndërmarrjet, Ligji e punës në Kosovë, Ligjit mbi trustin pensional në Kosovë, si dhe Konventës Evropiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, kamatave ligjore të parapara sipas Ligjit për AKP – Shtojca e Ligjit dhe Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Përfaqësuesi i ankuesve përfundimisht, me anë të këtyre parashtresave, kërkoj kompensimin e pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe atë si në vijim:

- për ankuesin 1 M G shumën 796.11 (shtatë nëntë gjashtë një një) Euro,
- për ankuesin 3 R B shumën prej 1,855.14 (një tetë pesë pesë një katër) Euro,
- për ankuesin 4 A M shumën prej 2,246.10 (dy dy katër gjashtë një zero) Euro,
- për ankuesin 5 F B shumën prej 1,049.07 (një zero katër nëntë zero shtatë) Euro,
- për ankuesin 6 I H shumën prej 3,480.60 (tre katër tetë zero gjashtë zero) Euro,
- për ankuesin 7 Sh N shumën prej 2,164.32 (dy një katër tre dy) Euro,
- për ankuesin 8 S K shumën prej 2,786.98 (dy shtatë tetë gjashtë nëntë tetë) Euro, dhe
- për ankuesin 9 H B shumën prej 3,286.10 (tre dy tetë gjashtë një zero) Euro,

Përfaqësuesi i ankuesve, kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në lartësi prej 312.00 Euro, për ankuesit e cekur si më lartë veç e veç, dhe atë në emër të kërkesave pranë AL, shqyrtimin e shkresave të lëndës , kërkesave për rishikim-ankesave dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP, si dhe kompensimin e taksave gjyqësore në shumë prej 20.00 Euro.

Parashtresave, i janë bashkangjitur si në vijim:

- Kopja e listës së pagave të punëtorëve, të NSH, të llogaritura për tre muaj, datë 31 mars 2006 (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE),
- Kopja e Listës përfundimtare të punëtorëve të NSH, të cilët kanë përfituar të drejtën e një pjese të hyrave nga privatizimi i NSH (në tekstin në vijim LISTA E PUNËTORËVE),
- Një listë të punëtorëve të cilët kanë pranuar NJOFTIMIN,
- Kopje të listës së pagave për ankuesin 9 H I

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 14 gusht 2024 parashtrorj përgjigjen.

AKP kundërshtoj kërkesën për rishikim -ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesat e ankuesve ka vendosur në pajtim me dispozitat ligjore. AKP tutje se kërkesa për rishikim nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe Ligjit për procedurën kontestimore - LPK. AKP përfundimisht pohon se kërkesat e ankuesve, që të gjitha veç e veç, konsiderohen të parashkruara, në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP lidhur Ligjin për punën e bashkuar- LPB. Nga gjitha arsyet propozoj që kërkesa e ankuesve për rishikim- ankesa të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopjet e Vendimeve të AL, për ankuesit, 1,3,4,5,6,7,8 dhe 9,
- Kërkesa kreditore e ankuesit 2 B Z e parashtruar pranë AL, dhe

- Kopja e Vendimit për emërimin e AL.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, përfaqësuesi i ankuesve me 23 gusht 2024 parashtrorj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesi kundërshtorj përgjigjen e AKP dhe mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës si dhe parashtrësave mbi precizimin e kërkesave për rishikim-ankesave, të parashtruara me 3 qershor 2020. Përfaqësuesi i ankuesve, edhe me anë të kësaj përgjigje, kundërshtorj pohimet e AKP lidhur me parashkrimin si dhe ju referua Vendimeve të DHPGJS.

Përfaqësuesi i ankuesit kërkorj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shumë totale prej 1,872.00 Euro, dhe atë në emër të kërkesave pranë AL, shqyrtimin e shkresave të lëndës, kërkesave për rishikim-ankesave dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP.

Me 26 gusht 2024, gjykata lëshorj një urdhër për përfaqësuesin e ankuesve me të cilin ju kërkuarj që të parashtrorj kopjen e Vendimit të AL, për ankuesin 2 B Z ndaj të cilit është parashtruar kërkesa për rishikim-ankesa.

Përfaqësuesi i ankuesit nuk e ka përmbushur urdhrin.

Në përgjigjen e parashtruar, pranë gjykatës, me datë 9 shtator 2024 ka informuar gjykatën, se lidhur me kërkesën e ankuesit 2 B Z ,AL nuk ka vendosur lidhur me kërkesën e këtij ankuesit, që nënkupton se nuk disponon vendimin e AL.

Arsyetimi ligjor:

a. Kërkesa e ankuesit 2,

Kërkesa për rishikim-ankesa e ankuesit 2, B Z konsiderohet e papranueshme.

Fillimisht Neni 74.2, i Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për DHPGJS), përcakton:

“Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtorj vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi”.

Sipas nenit si më lartë, ankesa – kërkesa për rishikim mund të parashtrohet vetëm në rastin kur AL vendos lidhur me kërkesën e ankuesit, në këtë rast mbi pagat, dhe atë në afat prej 30 ditëve.

Në rastin konkret, AL nuk ka vendosur lidhur me kërkesën e ankuesit andaj edhe kërkesa e ankuesit 2, B Z nuk mund të merret në shqyrtim.

Tutje neni 36 paragrafi 2.6 i Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086) parashihet se një padi/ankesë konsiderohet e pranueshme nëse është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa.

Edhe me këtë rast, siç pohon edhe vetë përfaqësuesi i ankuesve, Vendimi i AL nuk është lëshuar andaj gjykata nga gjitha arsyet e cekura ligjore konsideron se kërkesa për rishikim-ankesa për ankuesin 2, B Z konsiderohet e papranueshme.

Nga gjitha arsyet u vendos si në pikën 1 të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

b. Kërkesa e ankuesve 1. M G 3. R B4. A M 5. F B6. I H 7. Sh N8. S K dhe 9. H I

Kërkesa për rishikim, e ankuesve 1,3,4,5 dhe 7 konsiderohet si e bazuar gjersa ankuesve 6, 8 dhe 9 si pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit (ligji nr. 06/L-086) për DHPGJS, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata, në rastin konkret, konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartë cekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë pohimet e ankuesit dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

NJOFTIMET, LISTA E PUNËTORËVE e punëtorëve e publikuar nga AKP, librezat e punës., argumentojnë pohimet e ankuesve se të njëjtit ka qenë punëtor aktiv të NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, respektivisht 24 mars 2006.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankueseve respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesve do ti ju mohohet e drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e listuara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesve. AKP për më tepër të drejtën në kompensim të ankuesve, si në Vendimet e saj ashtu edhe me përgjigjen e saj, e bazon në parashkrimin e kërkesave.

Gjykata gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15

dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.3, në kuptim të kompensimit, nga përvoja e tyre e punës, ankuesve 1- M G dhe 6-I H i takojnë 3 (tri) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesve, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (10 deri në 19 vite shërbimi). Ky fakt mbi përvojën e tij të punës është vërtetuar nga LISTA E PUNËTORËVE ku shihet përvoja e tyre e punës me 18 vite 4 muaj e 4 ditë respektivisht 18 vite 7 muaj e 4 ditë, por dhe pohimeve të vetë ankuesit 1- M G mbi përvojën e tij të punës.

Lidhur me ankuesit tjerë, 3-R B 4-A M 5-F B7-Sh N8-S K dhe 9 -H I gjykata gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4, në kuptim të kompensimit, nga përvoja e tyre e punës, ju takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesve, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 deri në 29 vite shërbimi). Ky fakt mbi përvojën e tyre të punës është vërtetuar nga LISTA E PUNËTORËVE, publikuar nga AKP ku shihet përvoja e tyre e punës, si ankuesi 3-R B me 20 vite 7 muaj e 8 ditë, ankuesi 4-A M 20 vite 8 muaj e 1 ditë, ankuesi 5-F B 20 vite 7 muaj e 4 ditë, ankuesi 7-Sh N21 vite 7 muaj e 8 ditë, ankuesin 8-S K 22 vite 4 muaj e 9 ditë dhe ankuesin 9-H I 22 vite 8 muaj e 9 ditë.

Në rastin konkret me rastin e vendosjes, për secilin ankues veç e veç, mbi shumën e kërkesave gjykata vendosi si në vijim.

Ankuesi 1-M G

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 1- M G ishte në shumë prej 265.37 Euro. Këtë pagë e shumëzoi për tre (3) paga, ashtu siç parashihet sipas dispozitës së cekur si më lartë, andaj konsideroj se ankuesi në fjalë i takon shuma prej 796.11 Euro ($261.91 \times 3 = 785.13$), shumë kjo edhe e kërkuar nga ankuesi.

Ankuesi 3-R B

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 3- R B ishte në shumë prej 309.19 Euro. Këtë pagë e shumëzoi për gjashtë (6) paga, ashtu siç parashihet sipas dispozitës së cekur si më lartë, andaj konsideroj se ankuesi në fjalë i takon shuma prej 1,855.14 Euro ($309.19 \times 6 = 1,855.14$), shumë kjo edhe e kërkuar nga ankuesi.

Ankuesi 4- A M

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 4- A M ishte në shumë prej 374.35 Euro. Këtë pagë e shumëzoi për gjashtë (6) paga, ashtu siç parashihet sipas dispozitës së cekur si më lartë, andaj konsideroj se ankuesi në fjalë i takon shuma prej 2,246.10 Euro ($374.35 \times 6 = 2,246.10$), shumë kjo edhe e kërkuar nga ankuesi.

Ankuesi 5- F B

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 5 -F B ishte në shumë prej 349.69 Euro. Mirëpo, gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shumën e kërkuar në lartësi prej 1,049.07 (një zero katër nëntë zero shtatë) Euro, vendosi në kuptim të nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 (vendosja brenda kufijve të kërkesave) të Ligjit për procedurën kontestimore –LPK, në rastin konkret brenda kufijve të kërkesës së vetë ankuesit.

Ankuesi 6-I H

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 1-I H ishte në shumë prej 580.10 Euro. Këtë pagë e shumëzohj për tre (3) paga, ashtu siç parashihet sipas dispozitës së cekur si më lartë, andaj konsiderohj se ankuesi në fjalë i takon shuma prej 1,740.30 Euro ($580.10 \times 3 = 1,740.30$).

Pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 1,740.30 Euro, nga shuma e kërkuar nga ankuesi prej 3,480.60 Euro, pasi që nuk është dëshmuar ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS, konsiderohet e pabazuar pasi që nuk është argumentuar.

Ankuesi 7-Sh N

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 7-Sh N ishte në shumë prej 360.72 Euro. Këtë pagë e shumëzohj për gjashtë (6) paga, ashtu siç parashihet sipas dispozitës së cekur si më lartë, andaj konsiderohj se ankuesi në fjalë i takon shuma prej 2,164.32 Euro ($360.72 \times 6 = 2,164.32$), shumë kjo edhe e kërkuar nga ankuesi.

Ankuesi 8-S K

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 8-S K ishte në shumë prej 398.14 Euro. Këtë pagë e shumëzohj për gjashtë (6) paga, ashtu siç parashihet sipas dispozitës së cekur si më lartë, andaj konsiderohj se ankuesi në fjalë i takon shuma prej 2,388.84 Euro ($398.14 \times 6 = 2,388.84$).

Pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 398.14 Euro, nga shuma e kërkuar nga ankuesi prej 2,786.98 Euro, pasi që nuk është dëshmuar ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS, konsiderohet e pabazuar pasi që nuk është argumentuar.

Ankuesi 9 -H I

Nga LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, shihet se paga e ankuesit 9-H B ishte në shumë prej 469.43 Euro. Këtë pagë e shumëzohj për gjashtë (6) paga, ashtu siç parashihet sipas dispozitës së cekur si më lartë, andaj konsiderohj se ankuesi në fjalë i takon shuma prej 2,816.58 Euro ($469.43 \times 6 = 2,816.58$).

Pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 469.43 Euro, nga shuma e kërkuar nga ankuesi prej 3,286.01 Euro, pasi që nuk është dëshmuar ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS, konsiderohet e pabazuar pasi që nuk është argumentuar.

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesit, si më lartë, kanë arritur që të dëshmojnë të drejtën në kompensim, ashtu siç parashihet sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Andaj, nga gjitha arsyet si më lartë, gjykata vendosi në pikat 4 gjer 11 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kamatën ligjore, të aprovuara për ankuesit, veproj në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP, ku thuhet si në vijim: “*të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore*”, andaj edhe vendosi si në pikat 4 gjer 11 të dispozitivit.

Çështja e parashkrimit të kërkesave të ankuesve

Gjykata konsideron se ankuesit kanë arritur ta dëshmojnë, me anë të NJOFTIMI dhe LISTËS SË PUNËTORËVE se ishin punëtor legjitim të NSH gjer me datën 26 mars 2006 andaj pavarësisht pohimeve të AKP, është dëshmuar se ankuesit ishin punëtor i NSH gjer me datën e fillimit privatizimit, dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me veprimin e Agjencisë (neni 40 i Shtojcës së Ligjit për AKP).

AL me anë të vendimeve të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikës 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Sipas nenit 370, të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare RSFJ nr. 29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85, 45/89, 31/93), thuhet:

“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitat e lartë cekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Rregullat për parashkrimin, në rastin konkret, nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankuesit, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Tutje duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventual, afatet e parashkrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartë cekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (*lex specialis*).

Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesit nuk kanë inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Taksa gjyqësore është paguar.

Bazuar në nenin 6.2 lidhur me nenin 6.1 të Rregullores për tarifën e avokatëve, datë 18 mars 2017, vendosi si në pikën dymbëdhjetë (12) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Shuma e mbetur prej 624.00 (gjashtë dy katër) Euro, për përfaqësim pranë AL refuzohet me arsyetim se përfaqësuesit në rastin konkret mund ti gjykohen vetëm se shpenzimet për përfaqësim pranë gjykatës e jo edhe pranë AL. Lidhur me shikimin e shkresave përfaqësuesi nuk ka bërë një veprim të tillë.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar